



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 775/4 Prot.

Tiranë, më 25.11. 2015

**V E N D I M**  
(i ndërmjetëm)

Nr. 126, datë 25.11. 2015

***"Në lidhje me shtyrjen e afatit të fillimit të mbikëqyrjes në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Fier".***

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr.122, datë 06.11.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Fier", ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes tematike në institucionin e Bashkisë Fier, duke planifikuar që ky proces të fillonte në datën 23.11.2015.

Ndërkohë, me shkresën nr.775/3, datë 17.11.2015, "Kërkesë për shtyrje të afatit të Mbikëqyrjes", nga ana e subjektit të mbikëqyrjes është kërkuar shtyrja e afatit për fillimin e procesit, me argumentin se i nevojitej kohë për të grumbulluar dokumentacionin e kërkuar në programin e mbikëqyrjes, për të siguruar ecurinë normale të procesit.

Sa më sipër, duke vlerësuar rrethanat e parashtruara nga subjekti i mbikëqyrjes, çmoj se kërkesa është e bazuar dhe duhet të miratohet.

**Për këtë arsye,**

në mbështje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1, 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe të Rregullores "Mbi procedurat e Mbikëqyrjes/Inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit,

**VENDOSA:**

1. Të miratoj kërkesën për shtyrjen e afatit të fillimit të procesit të mbikëqyrjes tematike në institucionin e Bashkisë Fier.

2. Për këtë vendim të njoftohet institucioni si dhe grupi i mbikëqyrjes.
3. Procesi i mbikëqyrjes për këtë subjekt duhet të përfshihet në planin vjetor të punës së Komisionerit, për vitin 2016.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithëshme e Mbikëqyrjes dhe inspektimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**